



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

V E N D I M

Nr. 498, datë 28.09.2023

PËR

KUALIFIKIMIN PËR EMËRIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...} PËR POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR NË NJËSITË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATAVE TË APELIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 28.09.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për miratimin e projektvendimeve për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. Jona Biba dhe znj. {...} për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e znj. {...},

V Ë R E N

I. MBI FAKTET E PROCESIT TË KUALIFIKIMIT DHE VIJIMIT TË PROCEDURËS SË EMËRIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...}

1. Me vendimin nr. 125, datë 04.04.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim Këshilli) konstatoi se znj. {...} plotësonte kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022-2023, profili ndihmës ligjor. Ky verifikim u krye bazuar në nenet 34 pika 6, 53 pika 4, 55 dhe 56, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim si “Ligji për Pushtetin Gjyqësor”).
2. Me vendimin nr. 213, datë 16.06.2022, mbështetur në nenin 53, të ligjit “Për Pushtetin Gjyqësor”, si dhe në Vendimin e tij nr. 424/2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli, ka filluar procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për ndihmës

ligjorë, viti akademik 2022 - 2023, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat.

3. Në përfundim të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për pozicionin e ndihmësit ligjor, Këshilli me vendimin nr. 543, datë 14.12.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidates fituese znj. {...} dhe lejimin e saj për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor.
4. Znj. {...} ka ndjekur programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor viti akademik 2022-2023 në Shkollën e Magjistraturës. Me Vendimin nr. 30, datë 18.07.2023, “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”, Shkolla e Magjistraturës e rendit të parën në listën e kandidatëve, me 78.6 % të pikëve (më shumë se 70% të pikëve në total).

II. VLERËSIME MBI VERIFIKIMIN E KUSHTIT FORMAL TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR ZNJ. {...}

5. Për znj. {...} u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, të përcaktuar në nenin 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, kushte të cilat përcaktohen si kriteret të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil edhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:
 - a) *Të jetë shtetas shqiptar* - Për këtë kriter, në dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 16.05.2013, pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Nuk rezulton ndonjë e dhënë për lënien ose heqjen e shtetësisë shqiptare për subjektin pas këtij momenti;
 - b) *Të ketë zotësi të plotë për të vepruar* - Për këtë kriter, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) *Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur* - Zotërimi i gjuhës shqipe të folur dhe të shkruar prezumohet për çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar arsimin e detyrueshëm;
 - d) *Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse* - Subjekti rezulton se është në kushte shëndetësore të cilat e lejojnë të kryejë detyrën pasi, sipas raportit mjeko-ligjor, të datës 04.02.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetsore Përmet, ka rezultuar "I aftë për punë" dhe nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme për cenimin e kësaj aftësie;
 - e) *Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje* - Sipas informacionit të përpunuar nga Struktura e Posaçme pranë KLGJ¹, referuar dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se znj. {...} nuk është e dënuar me vendim penal

¹Shih shkresën me 3653/1 prot., datë 21.07.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

të formës së prerë. Gjithashtu, nga të dhënat e dosjes personale dhe tërësia e dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit, nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme që të cenojnë përmbushjen këtij kriteri;

- f) *Ndaj saj të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.* - Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas vetëdeklarimit të bërë nga znj. {...} në jetëshkrimin (CV) e depozituar në dosjen e saj të aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe shënimet në librezën e punës u konstatua se ajo ka qenë e punësuar si juriste pranë drejtorisë së Shërbimit Spitalor Përmet që nga data 01.07.2015 deri në 31.12.2015 dhe më pas si sekretare gjyqësore pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet nga 25.03.2016 dhe deri në momentin e fillimit të Shkollës së Magjistraturës, nga ku rezultoi se znj. {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

III. KONKLUZIONI

6. Në gjithë sa më sipër, duke konstatuar se znj. {...}:
- plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit për nëpunësit civil gjyqësor në kategorinë këshilltar ligjor;
 - ka përfunduar me sukses Shkollën e Magjistraturës, e cila me vendimin e saj nr. 30, datë 18.07.2023, *“Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për ndihmës ligjor në Programin e Formimit Fillestar”*, e ka renditur në listën e kandidatëve fitues, duke e klasifikuar të parën me 78.6 % të pikëve, (më shumë se 70% të pikëve në total);
 - është kualifikuar në procesin e verifikimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, sipas vendimit të KLGJ-së nr. 543, datë 14.12.2022, *“Për kualifikimin e kandidates fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor, znj. {...}”*,

Këshilli vlerëson t'a kualifikojë për emërimin në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të apelit.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.115/2016, *“Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, në nenet 36, 42 dhe 59, të ligjit nr. 98/2016, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”*, si dhe në Vendimin e tij nr. 543, datë 14.12.2022, *“Për kualifikimin e kandidates fituese për në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022 – 2023, profili ndihmës ligjor, znj. {...}”*, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin për emërimin në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR